



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 162

Tiranë – E hënë, 2 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 73/2019 datë 4.11.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, ‘Për buxhetin e vitit 2019’”..... 12905
Ligj nr. 74/2019 datë 4.11.2019	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 2.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’”, të ndryshuar..... 12905
Ligj nr. 77/2019 datë 11.11.2019	Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën kundër Falsifikimit të Monedhës..... 12905
Dekret i Presidentit nr.11368, datë 25.11.2019	Për shpallje ligji..... 12913
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 30.11.2019	Për një shtesë në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar..... 12913
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 7, datë 30.11.2019	Për një shtesë në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 12913
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 752, datë 30.11.2019	Për një shtesë në vendimin nr.666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike” 12914
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.756, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar znj. Pranvera Qato..... 12914
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.757, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar znj. Lindita Cara..... 12915

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 758, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar z. Albert Cara.....	12915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 759, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar z. Aleks Çupi.....	12915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr.760, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar z. Albert Lala.....	12916
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 761, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar znj. Denisa Greku.....	12916
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 762, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar znj. Marjana Rexhepi.....	12916
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar z. Fehmi Vata.....	12916
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 764, datë 2.12.2019	Për dhënie trajtimi të veçantë financiar znj. Diana Steneci.....	12917
Vendim i Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile nr. 2, datë 30.11.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr.1, datë 29.11.2019, të Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, “Për caktimin e drejtuesve qendrorë të operacionit për menaxhimin e fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës dhe Tiranë”	12917
	Ndreqje gabimi material në vendimin nr. 700, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin me pagesë të qirasë së disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit ‘Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës’”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 147, viti 2019.....	12917
	Ndreqje gabimi në aktin normativ nr. 4, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 161, viti 2019.....	12918



LIGJ
Nr. 73/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 2, DATË
2.10.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 99/2018, ‘PËR BUXHETIN
E VITIT 2019’”**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 2, datë 2.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 99/2018, ‘Për buxhetin e vitit 2019’”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratur në datën 4.11.2019

LIGJ
Nr. 74/2019

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 3, DATË
2.10.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR DISA SHTESA
NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006,
‘PËR SISTEMIN E TAKSAVE
VENDORE’”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 3, datë 2.10.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ‘Për sistemin e taksave vendore’”, të ndryshuar.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratur në datën 4.11.2019

LIGJ
Nr. 77/2019

**PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS
NDËRKOMBËTARE PËR LUFTËN
KUNDËR FALSIFIKIMIT TË
MONEDHËS**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratur në datën 11.11.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11368, datë 25.11.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.



**KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR
LUFTËN KUNDËR
FALSIFIKIMIT TË MONEDHËS**

(Gjenevë, 20 prill 1929)

HYRJA NË FUQI: 22 SHKURT 1931

Depozituesi: Sekretari i Përgjithshëm i
Kombeve të Bashkuara

Madhëria e Tij Mbreti i Shqipërisë; Presidenti i Raihut Gjerman; Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës; Presidenti Federal i Republikës Austriake; Madhëria e Tij Mbreti i Belgëve; Madhëria e Tij Mbreti i Britanisë së Madhe, Irlandës dhe Dominioneve Britanike të Përtejdetit, Perandor i Indisë; Madhëria e Tij Mbreti i Bullgarëve; Presidenti i Qeverisë Kombëtare të Republikës së Kinës; Presidenti i Republikës Kolumbiane; Presidenti i Republikës së Kubës; Madhëria e Tij Mbreti i Danimarkës; Presidenti i Republikës Polake, për Qytetin e Lirë të Danzig; Madhëria e Tij Mbreti i Spanjës; Presidenti i Republikës Franceze; Presidenti i Republikës Helene, Lartësia e Tij e Paqtë Regjenti i Mbretërisë së Hungarisë; Madhëria e Tij Mbreti i Italisë; Madhëria e Tij Perandori i Japonisë; Madhëria e Saj Mbretërore Grand Dukesha e Luksemburgut; Lartësia e Tij e Paqtë Princi i Monakos; Madhëria e Tij Mbreti i Norvegjisë; Presidenti i Republikës së Panamasë; Madhëria e Saj Mbretëresha e Holandës; Presidenti i Republikës Polake, Presidenti i Republikës Portugeze; Madhëria e Tij Mbreti i Rumanisë; Madhëria e Tij Mbreti i Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve; Komiteti Qendror Ekzekutiv i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike; Këshilli Federal Zvicëran; Presidenti i Republikës Çekoslovake,

me dëshirën për ta bërë gjithnjë e më efektiv parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të monedhës, kanë caktuar si përfaqësues fuqplotë:

Madhërinë e Tij Mbretin e Shqipërisë:

Dr. Stavro Stavri, i ngarkuar me punë në Paris;

Presidenti i Raihut gjerman:

Dr. Erich Kraske, “Vortragender legationsrat” në Ministrinë për Punët e Jashtme;

Dr. Wolfgang Mettgenberg, “Ministerialrat” në Ministrinë e Drejtësisë së Raihut;

Dr. Vocke, “Geheimer Finanzrat”, anëtar i drejtorisë së Bankës së Raihut;

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës:

Z. Hugh R. Wilson, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe fuqplotë pranë Këshillit Federal Zvicëran;

Presidenti Federal i Republikës Austriake:

Dr. Bruno Schultz, drejtor i Policisë, shef i Seksionit të Policisë Penale në Prefekturën e Policisë së Vjenës;

Madhëria e Tij Mbreti i Belgëve:

M. Servais, ministër Shteti, Prokuror Publik Nderi në Gjykatën e Apelit të Brukselit;

Madhëria e Tij Mbreti i Britanisë së Madhe, Irlandës dhe Dominioneve Britanike të Përtejdetit:

Për Britaninë e Madhe dhe Irlandën e Veriut dhe të gjitha pjesët e Perandorisë Britanike që nuk janë anëtarë të veçantë të Lidhjes së Kombeve:

Sër Jon Fischer Williams, përfaqësues ligjor britanik në Komisionin e Reparacioneve;

Leslie S. Brass, Esq., Asistent Drejtues në Ministrinë e Brendshme;

Për Indinë:

Vernon Dawson, Esq., drejtues i zyrës për Indinë;

Madhëria e Tij Mbreti i Bullgarëve:

M.D. Mikoff, i ngarkuar me punë në Bernë;

Presidenti i Qeverisë Kombëtare të Republikës së Kinës:

M. Lone Liang, këshilltar i Legatës së Kinës pranë Presidentit të Raihut gjerman;

Presidenti i Republikës Kolumbiane:

Dr. Antonio Jose Restrepo, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqplotë, Delegat i Përhershëm i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

Presidenti i Republikës së Kubës:

M. G. de Blanck Y Menocal, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqplotë, Delegat i Përhershëm i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

M. Manuel R. Alvarez, atashë tregtar pranë Delegacionit të Përhershëm të akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

Madhëria e Tij Mbreti i Danimarkës:

M. William Borberg, Delegat i Përhershëm i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

Presidenti i Republikës Polake për Qytetin e Lirë të Danzig:

M. Francois Sokal, ministër fuqplotë, delegat i Republikës Polake i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

Madhëria e Tij Mbreti i Spanjës:



M. Mauricio Lopez Roberts, Marquis de la Torrehermosa, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqplotë pranë Këshillit Federal Zviceran;

Presidenti i Republikës Franceze:

Konti de Chaklendar, atashe financiar në Ambasadën e akredituar pranë Madhërisë së tij Britanike;

Presidenti i Republikës Helene:

M. Megalos Caloyanni, “Konsull Nderi” pranë Gjykatës së Lartë të Apelit në Kajro;

Lartësia e Tij e Paqtë Regjenti i Mbretërisë së Hungarisë:

M. P. de Hevesy de Heves, ministër rezident, delegat i përhershëm i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

Madhëria e Tij Mbreti i Italisë:

Commendatore Dr. Ugo Aloisi, këshilltar pranë “Gjykatës së Kasacionit”, atashe pranë Ministrisë së Drejtësisë;

Madhëria e Tij Perandori i Japonisë:

M. Raizaburo Hayashi, prokuror publik i Gjykatës së Lartë;

M. Shigeru Nagai, drejtor i Prodhimit të Monedhave Perandorake;

Madhëria e Saj Mbretërore Grand Dukësia e Luksemburgut:

M. Charles G. Vermaire, konsull në Gjenevë;

Lartësia e tij e Paqtë Princi i Monakos:

M. Rodolphe Elles, nënkonsull në Gjenevë;

Madhëria e Tij Mbreti i Norvegjisë:

M. Chr. L. Lange, Sekretar i Përgjithshëm i Unionit Ndërparlamentar;

Presidenti i Republikës së Panamasë:

Dr. Arosemena, Sekretar Shteti për Punët e Jashtme;

Madhëria e Saj Mbretëresha e Holandës:

Baron A. A. Van der Feltz, ish-shef i Zyrës Qendrore Holandeze për Goditjen e Falsifikimeve, ish-Prokuror i Përgjithshëm pranë Gjykatës së Apelit të Amsterdimit;

M. P. J. Gerke, Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit pranë Departamentit të Financës së Indive Holandeze;

M. K. H. Broekhoff, komisioner (drejtor) Shtetëror i Policisë, Kryeinspektor i Policisë;

Presidenti i Republikës Polake:

M. Francois Sokal, ministër fuqplotë, delegat i Republikës Polake i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

Dr. Włodzimierz Sokalski, Gjykatës në Gjykatën e Lartë;

Presidenti i Republikës Portugeze:

Dr. Jose Caeiro da Matta, drejtor i Bankës së Portugalisë, profesor i ligjit në Universitetin e Lisbonës;

Madhëria e Tij Mbreti i Rumanisë:

M. Constantin Antoiade, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër fuqplotë i akredituar pranë Lidhjes së Kombeve;

M. Vespasien V. Pella, profesor i së drejtës penale në Universitetin e Jasys;

M. Pascal Toncesco, këshilltar në Gjykatën e Apelit;

Madhëria e Tij Mbreti i Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve:

Dr. Thomas Givanovitch, profesor i së drejtës penale në Universitetin e Beogradit;

Komiteti Qendror Ekzekutiv i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike:

M. Georges Lachkevitch, këshilltar ligjor në Ambasadën e Bashkimit, i akredituar pranë Presidentit të Republikës Franceze;

M. Nicolas Lubimov, atashe në Ambasadën e Bashkimit, i akredituar pranë Presidentit të Republikës Franceze;

Këshilli Federal Zviceran:

M. E. Delaquis, shef i Divizionit të Policisë së Departamentit Federal të Drejtësisë dhe Policisë, profesor i ligjit në Universitetin e Bernës;

Presidenti i Republikës Çekosllovaqe:

M. Jaroslav Kallab, profesor i së drejtës Penale dhe Ndërkombëtare në Universitetin e Bernës, të cilët, pasi kanë komunikuar kompetencat e tyre të plota të konstatuara në formë të mirë dhe të duhur, ranë dakord për dispozitat e mëposhtme:

PJESA I

Neni 1

Palët e Larta Kontraktuese njohin rregullat e përcaktuara në pjesën I të kësaj Konvente si mjetin më efektiv në rrethanat aktuale për të siguruar parandalimin dhe dënimin e veprës së falsifikimit të parave.



Neni 2

Në këtë Konventë, fjala “monedhë” nënkupton monedhën letër (duke përfshirë kartëmonedhat) dhe monedhën metalike, qarkullimi i të cilave është i autorizuar ligjërisht.

Neni 3

Sa më poshtë duhet të dënohen si krime ordinere:

1. Çdo prodhim apo ndryshim mashtrues i monedhës, pavarësisht se çfarë mjjetesh përdoren;

2. Hedhja në qarkullim mashtrues e monedhës të falsifikuar;

3. Prezantimi në një vend ose marrja ose përftimi i monedhës të falsifikuar, me synim qarkullimin e tyre dhe duke pasur dijeni se janë të falsifikuara;

4. Përpjekjet për të kryer dhe çdo pjesëmarrje e qëllimshme në aktet e mësipërme;

5. Prodhimi, marrja ose përftimi mashtrues i instrumenteve apo artikujve të tjerë të përshtatur posaçërisht për falsifikimin apo ndryshimin e monedhës.

Neni 4

Secili nga aktet e përmendura në nenin 3, nëse kryhet në shtete të ndryshme, duhet të konsiderohet si një veprë e veçantë.

Neni 5

Nuk duhet bërë asnjë dallim në shkallën e dënimeve për veprat e referuara në nenin 3, ndërmjet akteve që lidhen me monedhën vendëse nga njëra anë dhe monedhës së huaj nga ana tjetër; kjo dispozitë nuk mund të bëhet objekt i ndonjë kushti trajtimi reciprok me ligj apo me traktat.

Neni 6

Në vendet ku njihet parimi i njohjes ndërkombëtare të dënimeve të mëparshme, dënimet e huaja për veprat e referuara në nenin 3, brenda kushteve të parashikuara nga ligji vendës, duhet të njihen për qëllim të përcaktimit të kriminalitetit të zakonshëm.

Neni 7

Në masën që “palët civile” pranohen sipas ligjit vendës, duke përfshirë edhe “palët civile” të huaja, nëse është e nevojshme, Pala e Lartë Kontraktuese, monedha e së cilës është falsifikuar, duhet të gëzojë të gjitha të drejtat që u lejohen banorëve, sipas ligjeve të vendit në të cilin gjykohet çështja.

Neni 8

Në vendet ku nuk njihet parimi i ekstradimit të shtetasve, shtetasit që janë kthyer në territorin e vendit të tyre, pasi kanë kryer jashtë vendit një veprë të referuar në nenin 3, duhet të dënohen në të njëjtën mënyrë sikur vepra të ishte kryer në territorin e tyre, edhe në rastin kur shkelësi ka marrë shtetësinë e tij pas kryerjes së veprës.

Kjo dispozitë nuk zbatohet nëse, në një rast të ngjashëm, ekstradimi i një shtetasi të huaj nuk mund të miratohet.

Neni 9

Shtetasit e huaj, që kanë kryer jashtë vendit ndonjë veprë të referuar në nenin 3 dhe që ndodhen në territorin e një vendi, legjislacioni i brendshëm i të cilit e njeh si rregull të përgjithshëm parimin e ndjekjes penale të veprave të kryera jashtë vendit, duhet të dënohen në të njëjtën mënyrë sikur vepra të ishte kryer në territorin e atij vendi.

Detyrimi për të kryer procedimet është objekt i kushtit që ekstradimi është kërkuar dhe se vendi të cilit i është dërguar kërkesa nuk mund të dorëzojë personin e akuzuar për arsye që nuk ka lidhje me veprën.

Neni 10

Veprat e referuara në nenin 3 duhet të konsiderohen se përfshihen si krime ekstradimi në ndonjë traktat ekstradimi që është lidhur apo që mund të lidhet më pas ndërmjet ndonjë prej Palëve të Larta Kontraktuese.

Palët e Larta Kontraktuese që nuk e kushtëzojnë ekstradimin për ekzistencën e një traktati apo reciprociteti, i njohin më pas veprat e referuara në nenin 3, si raste ekstradimi ndërmjet tyre.



Ekstradimi do të miratohet në përputhje me ligjin e vendit të cilit i drejtohet kërkesa.

Neni 11

Monedha e falsifikuar, si edhe instrumentet apo artikuj të tjerë të referuar në nenin 3 (5) duhet të sekuestrohen dhe konfiskohen. Pas konfiskimit, para të tilla, instrumentet apo artikujt e tjerë duhet t'i dorëzohen pas një kërkesë ose qeverisë, ose bankës që ka emetuar monedhën, me përjashtim të provave, kur ligji vendës kërkon ruajtjen e tyre si dosje në vendin ku ushtrohet ndjekja penale dhe çdo mostër/kopje, transmetimi i të cilave të zyrat qendrore e referuar në nenin 12, mund të çmohet e këshillueshme. Në çdo rast, të gjithë artikujt e tillë duhet të bëhen të përdorshëm.

Neni 12

Në çdo vend, brenda kuadrit ligjor vendës, hetimet mbi objektin e falsifikimit duhet të organizohen nga një zyrë qendrore.

Kjo zyrë qendrore duhet të jetë në kontakt të ngushtë, me:

- a) institucionet që emetojnë monedhën;
- b) me autoritetet policore brenda vendit;
- c) me zyrat qendrore të vendeve të tjera.

Në çdo vend duhet të centralizojë të gjithë informacionin e një natyre që lehtëson hetimin, parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të monedhës.

Neni 13

Zyrat qendrore të vendeve të ndryshme duhet të komunikojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën.

Neni 14

Çdo zyrë qendrore, në masën që konsiderohet e shpejtë, duhet t'u përcjellë zyrave qendrore të vendeve të tjera një set të mostrave jashtë qarkullimit të monedhës aktuale të vendit të tij.

Duke iu nënshtruar të njëjtit kufizim, ajo duhet të njoftojë rregullisht zyrat qendrore në vendet e huaja, duke u dhënë të gjitha karakteristikat e nevojshme:

a) emetimet e monedhës së re të prodhuara në vendin e saj;

b) tërheqjen e monedhës nga qarkullimi, qoftë për arsye skadimi apo ndryshe.

Me përjashtim të rasteve me interes thjesht vendës, çdo zyrë qendrore, në masën që e çmon të shpejtë, duhet të njoftojë zyrat qendrore në vendet e huaja:

1. Çdo zbulim të monedhës së falsifikuar. Njoftimi i falsifikimit të kartëmonedhës apo monedhës duhet të shoqërohet me një përshkrim teknik të falsifikimeve për t'u dërguar vetëm institucionit të cilit i është falsifikuar monedha. Duhet të transmetohet një riprodhim fotografik ose nëse është e mundur, një mostër e kartëmonedhës së falsifikuar. Në raste urgjente, një njoftim dhe përshkrim i shkurtër i bërë nga autoritetet policore mund t'u komunikohet me maturi zyrave qendrore të interesuara, pa cenuar njoftimin dhe përshkrimin teknik të lartpërmendur.

2. Hetimi dhe ndjekjet penale në rastet e falsifikimit dhe arrestimeve, dënimeve dhe dëbimeve të falsifikatorëve dhe, gjithashtu, kur është e mundur, lëvizjet e tyre së bashku me çdo detaj që mund të jetë i dobishëm dhe, në veçanti, përshkrimi i tyre, gjurmët e gishtave dhe fotografitë.

3. Detaje të zbulimeve të falsifikimeve që përcaktojnë nëse ishte i mundur sekuestrimi i të gjithë monedhës së falsifikuar të hedhur në qarkullim.

Neni 15

Me qëllim që të sigurohet, përmirësohet dhe zhvillohet një bashkëpunim i drejtpërdrejtë ndërkombëtar për parandalimin dhe dënimin e falsifikimit të monedhës, përfaqësuesit e zyrave qendrore të Palëve të Larta Kontraktuese duhet të organizojnë herë pas here konferenca me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të bankave paraprodhuese dhe të autoriteteve qendrore përkatëse. Organizimi dhe mbikëqyrja e zyrës qendrore të informacionit ndërkombëtar mund të përbëjnë një ndër temat e këtyre konferencave.

Neni 16

Transmetimi i letërkërkesave (1), në lidhje me veprat e referuara në nenin 3, duhet të mundësohet:



a) mundësisht nëpërmjet një komunikimi të drejtpërdrejtë midis autoriteteve gjyqësore, kur është i mundur nëpërmjet zyrave qendrore;

b) nëpërmjet një korrespondence të drejtpërdrejtë midis ministrave të Drejtësisë të dy vendeve ose nëpërmjet një komunikimi të drejtpërdrejtë prej autoritetit të vendit kërkues me ministrin e Drejtësisë të vendit që i drejtohet kërkesa;

c) nëpërmjet përfaqësuesit diplomatik apo konsullor të vendit kërkues në shtetin të cilit i bëhet kërkesa; ky përfaqësues do t'i dërgojë letërkërkesën autoritetit kompetent gjyqësor ose autoritetit të caktuar nga qeveria e vendit që i bëhet kërkesa dhe do të marrë drejtpërdrejt nga po ai autoritet dokumentet që tregojnë ekzekutimin e letërkërkesës.

Në rastet “a” dhe “c”, një kopje e letërkërkesave do t'i dërgohet njëkohësisht autoritetit të lartë të vendit që i bëhet kërkesa.

Me përjashtim kur bihet dakord ndryshe, letërkërkesat do të hartohen në gjuhën e autoritetit që bën kërkesën, në çdo rast, me kusht që vendi të cilit i bëhet kërkesa, mund të kërkojë një përkthim në gjuhën e tij, të certifikuar siç duhet nga autoriteti që bën kërkesën.

Secila Palë e Lartë Kontraktuese do të njoftojë secilën prej Palëve të tjera të Larta Kontraktuese mbi metodën apo metodat e transmetimit të përmendura më lart, të cilat do të njihen për letërkërkesat e Palës së Lartë të fundit Kontraktuese.

Derisa të kryhet një njoftim i tillë nga një Palë e Lartë Kontraktuese, procedurat e saj ekzistuese në lidhje me letërkërkesat do të mbeten në fuqi.

Ekzekutimi i letërkërkesave nuk i nënshtrohet pagesës së taksave apo shpenzimeve të çfarëdolloji, përveç shpenzimeve të ekspertëve.

Asgjë në këtë nen nuk duhet të interpretohet si angazhim nga Palët e Larta Kontraktuese për të miratuar, në çështjet penale, ndonjë formë apo metoda provash në kundërshtim me ligjet e tyre.

Neni 17

Pjesëmarrja e një Pale të Lartë Kontraktuese në këtë Konventë nuk duhet të interpretohet sikur ndikon në qëndrimin e asaj Pale për çështjen e përgjithshme të juridiksionit penal si një çështje të së drejtës ndërkombëtare.

Neni 18

Kjo Konventë nuk cenon parimin se veprat e përmendura në nenin 3 duhet që në secilin vend, pa lejuar asnjëherë pandëshkueshmëri, të përcaktohen, autorët të ndiqen penalisht dhe të dënohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të ligjit të tij vendës.

PJESA II

Neni 19

Palët e Larta Kontraktuese bien dakord që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet tyre, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, nëse nuk mund të zgjidhen me bisedime të drejtpërdrejta, do t'i referohen për vendim Gjykatës së Përhershme Ndërkombëtare të Drejtësisë. Megjithatë, kur njëra ose të gjitha Palët e Larta Kontraktuese që janë palë në atë mosmarrëveshje nuk duhet të jenë palë në Protokollin e datës 16 dhjetor 1920 (2) që lidhet me Gjykatën e Përhershme Ndërkombëtare të Drejtësisë ose një gjykatë arbitrazhi të ngritur në përputhje me Konventën e 18 tetorit 1907 për “Zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare” ose në ndonjë gjykatë tjetër arbitrazhi.

Neni 20

Kjo Konventë, ku tekstet në frëngjisht dhe anglisht janë autentike, do të ketë datën e sotme. Ajo do të jetë e hapur deri në datën 31 dhjetor 1929 për t'u nënshkruar në emër të çdo anëtarit të Lidhjes së Kombeve dhe në emër të çdo shteti joanëtar, i cili përfaqësohet në këtë Konferencë që hartoi këtë Konventë ose të cilit i dërgohet një kopje nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve.

Ajo do të ratifikohet dhe instrumentet e ratifikimit do t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do të njoftojë për marrjen e tyre të gjithë anëtarët e lidhjes dhe shtetet joanëtare të referuara më lart.

Neni 21

Pas datës 1 janar 1930, kjo Konventë do të jetë e hapur për anëtarësim në emër të çdo anëtarit të



Lidhjes së Kombeve dhe të çdo shteti joanëtar të referuar në nenin 20, në emër të të cilit ajo nuk është nënshkruar.

Instrumentet e anëtarësimit do t'i transmetohen Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do të njoftojë për marrjen e tyre të gjithë anëtarët e Lidhjes dhe shtetet joanëtare të referuara në nenin 20.

Neni 22

Vendet që janë gati të ratifikojnë Konventën, sipas paragrafit të dytë të nenit 20, apo të aderojnë në Konventë, sipas nenit 21, por dëshirojnë të paraqesin rezervat e tyre në lidhje me zbatimin e Konventës, mund të informojnë për këtë Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do ua komunikojë këto rezerva Palëve të Larta Kontraktuese, në emër të të cilave janë depozituar ratifikimet apo anëtarësimet dhe t'u kërkojë atyre nëse kanë ndonjë kundërshtim në lidhje to. Nëse, brenda 6 muajve nga data e komunikimit prej Sekretarit të Përgjithshëm, nuk është marrë ndonjë kundërshtim, pjesëmarrja në Konventën e vendit që paraqet rezerva do të konsiderohet e pranuar nga ana e Palëve të tjera të Larta Kontraktuese që janë objekt i atyre rezervave.

Neni 23

Ratifikimi ose anëtarësimi në këtë Konventë nga ndonjë Palë e Lartë Kontraktuese nënkupton që legjislacioni i saj dhe organizimi i saj administrativ janë në përputhje me rregullat që përmban kjo Konventë.

Neni 24

Në mungesë të një deklaratë kundërshtuese nga njëra prej Palëve të Larta Kontraktuese në kohën e nënshkrimit, ratifikimit apo anëtarësimit, dispozitat e kësaj Konvente nuk janë të zbatueshme për kolonitë, territoret e përtejdetit, protektoratet apo territoret nën mbikëqyrje apo nën mandat.

Megjithatë, Palët e Lartë Kontraktuese rezervojnë të drejtën për të aderuar në këtë Konventë, në përputhje me dispozitat e neneve 21 dhe 22, kolonitë e tyre, territoret e përtejdetit, protektoratet apo territoret nën mbikëqyrje apo nën mandat. Gjithashtu, ato rezervojnë të drejtën ta

denoncojnë atë veçmas, në përputhje me dispozitat e nenit 27.

Neni 25

Kjo Konventë nuk do të hyjë në fuqi derisa të jenë depozituar pesë ratifikime apo anëtarësime në emër të anëtarëve të Lidhjes së Kombeve apo shteteve joanëtare. Data e hyrjes së saj në fuqi do të jetë dita e nëntëmbëdhjetë pas marrjes së ratifikimit apo anëtarësimit të pestë nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve (3).

Neni 26

Pas hyrjes në fuqi të Konventës, në përputhje me nenin 25, çdo ratifikim apo anëtarësim i mëpasshëm do të hyjë në fuqi ditën e nëntëmbëdhjetë pas marrjes së tij nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve.

Neni 27

Kjo Konventë mund të denoncohet në emër të çdo anëtarit të Lidhjes së Kombeve apo shteti joanëtar, duke njoftuar me shkrim Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili do të informojë të gjithë anëtarët e Lidhjes dhe shtetet joanëtare të referuara në nenin 20. Një denoncim i tillë do të hyjë në fuqi një vit pas datës së marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve dhe do të funksionojë vetëm në lidhje me Palën e Lartë Kontraktuese në emër të së cilës është kryer njoftimi.

Neni 28

Kjo Konventë do të regjistrohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve në datën e hyrjes së saj në fuqi.

Me besimin e të plotfuqishmit e lartpërmendur kanë nënshkruar këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, në datën 20 prill 1929, në një kopje të vetme, e cila do të mbetet e depozituar në arkivat e Sekretariatit të Lidhjes së Kombeve, dhe kopje të vërtetuara të së cilës do t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Lidhjes dhe shteteve joanëtare të referuara në nenin 20.



PROTOKOLL

I. INTERPRETIME

Në momentin e nënshkrimit së Konventës në këtë datë, të plotfuqishmit nënshkrues deklarojnë se ata pranojnë interpretimet e dispozitave të ndryshme të Konventës të përshkruara më poshtë.

Nënkuptohe:

1. Se falsifikimi i një vule mbi një notë, kur efekti i kësaj vule e bën atë të vlefshme në një vend, do të konsiderohet si falsifikim i notës.

2. Se Konventa nuk cenon të drejtën e Palëve të Larta Kontraktuese për të rregulluar lirisht, sipas ligjit të tyre vendës, parimet mbi të cilat mund të vendoset një dënim më i lehtë apo asnjë dënim, prerogativën për falje apo mëshirë dhe të drejtën e amnistisë.

3. Se rregulli që përmban neni 4 i Konventës nuk modifikon në asnjë mënyrë rregullat e brendshme që përcaktojnë dënimet në rastin e shkeljeve të përsëritura. Ai nuk ndalon që i njëjti individ që është edhe falsifikues, edhe shpërndarës, të dënohet vetëm si falsifikues.

4. Se Palëve të Larta Kontraktuese u kërkohet që të ekzekutojnë letërkërkesat vetëm brenda kufijve të përcaktuar nga ligji i tyre vendës.

II. REZERVA

Palët e Larta Kontraktuese që bëjnë rezervat e përshkruara më poshtë e kushtëzojnë pranimin e Konventës mbi rezervat e referuara; pjesëmarrja e tyre, sipas rezervave të referuara, pranohet nga Palët e tjera të Larta Kontraktuese.

1. Qeveria e Indisë bën një rezervë për faktin që neni 9 nuk është i zbatueshëm për Indinë, ku autoriteti për hartimin e legjislacionit nuk është mjaftueshëm i hapur për të pranuar legjislacionin që përmban ai nen.

2. Në pritje të negociatave për heqjen e juridiksionit konsullor, të cilin ende e gëzojnë shtetasit e disa fuqive, qeveria kineze nuk mund të pranojë nenin 10, i cili përfshin një angazhim të përgjithshëm të qeverisë për të lejuar ekstradimin e një të huaji që akuzohet për falsifikimin e monedhës së një shteti të tretë.

3. Në lidhje me dispozitat e nenit 20, delegacioni i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike rezervon të drejtën që qeveria e tij t'ia kërkojë, nëse

dëshiron, instrumentin e tij të ratifikimit një shteti tjetër nënshkrues, në mënyrë që ky i fundit t'i dërgojë një kopje Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve për njoftimin e të gjitha shteteve nënshkruese apo që do të bëhen anëtare.

III. DEKLARATA

ZVICRA

Në momentin e nënshkrimit së Konventës, përfaqësuesi i Zvicrës bëri deklaratën e mëposhtme:

“Këshilli Federal Zviceran, duke mos qenë në gjendje të marrë përsipër asnjë detyrim në lidhje me klauzolat penale të Konventës para zgjidhjes pozitivisht të çështjes së prezantimit të një kodi të unifikuar penal në Zvicër, tërheq vëmendjen ndaj faktit se ratifikimi i Konventës nuk mund të bëhet në një kohë të caktuar paraprakisht.”

“Megjithatë, Këshilli Federal është i predispozuar të vërë në ekzekutim, në masën që i lejon autoriteti i tij, dispozitat administrative të Konventës, kurdo kur ato do të hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 25.”

BASHKIMI I REPUBLIKAVE SOCIALISTE SOVJETIKE

Në momentin e nënshkrimit të Konventës, përfaqësuesi i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike bëri deklaratën e mëposhtme:

“Delegacioni i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike, ndërsa pranon dispozitat e nenit 19, deklaroi se Qeveria e Bashkimit nuk propozon të paraqesë rekurs për sa i përket asaj, ndaj juridiksionit të Gjykatës së Përbërshme të Drejtësisë Penale.”

“Në lidhje me dispozitën e të njëjtit nen, sipas së cilës mosmarrëveshjet që mund të zgjidhen nëpërmjet negociatash të drejtëpërdrejta, do të dërgohen për çfarëdo procedure tjetër arbitrazhi të ndryshme nga ajo e Gjykatës së Përbërshme të Drejtësisë Penale, Delegacioni i Bashkimit të Republikave Socialiste Sovjetike shprehet qartë se pranimi i kësaj dispozite nuk duhet të interpretohet sikur modifikon pikëpamjen e Qeverisë së Bashkimit mbi çështjen e përgjithshme të arbitrazhit si mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet shteteve.”

Ky Protokoll, se në masën që krijon detyrime ndërmjet Palëve të Larta Kontraktuese, do të ketë të njëjtën fuqi, efekt dhe kohëzgjatje si Konventa e datës së sotme, e cila do të konsiderohet si pjesë përbërëse.

Me besimin e nënshkruesit kanë vendosur nënshkrimet e tyre në këtë Protokoll.



Bërë në Gjenevë, në ditën e njëzet të prillit 1929, në një kopje të vetme, e cila do të depozitohet në arkivat e Sekretariati të Lidhjes së Kombeve dhe kopje autentike të së cilës do t'u dërgohen të gjithë anëtarëve të Lidhjes së Kombeve dhe shteteve joanëtare të përfaqësuara në Konferencë.

DEKRET
Nr.11368, datë 25.11.2019

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 77/2019 “Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Luftën Kundër Falsifikimit të Monedhës”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr.5, datë 30.11.2019

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8438,
DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Në fund të pikës 1, të nenit 21, “Shpenzime të panjohura”, të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998, të ndryshuar, shtohet shkronja “p”, me këtë përmbajtje:

“p) Donacionet në mjete monetare mbi nivelin 5% të fitimit para tatimit, të bëra për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar, dhe të transferuara në llogaritë e thesarit. Në rastet kur donacionet për shkak të shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë

natyrore” janë në formën e pasurive të paluajtshme, vlerësimi i kontributit deri në nivelin 5%, në raport me fitimin para tatimit llogaritet sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

AKT NORMATIV
Nr. 7, datë 30.11.2019

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7703,
DATË 11.5.1993, “PËR SIGURIMET
SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Pas nenit 5/1, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, shtohet neni 5/1/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1/a
Trajtim i veçantë financiar

Pensionistët, që kanë humbur pjesëtarë të familjes si pasojë e fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga tërmeti i datës 26.11.2019, përfitojnë trajtim të veçantë financiar deri në masën e tetëfishit të pensionit social, ndërsa personat, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë deri në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social.

Pensionistët, që kanë humbur të gjithë pjesëtarët e familjes, përfitojnë vetëm trajtimin në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social.



Trajtimi i veçantë financiar caktohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave dhe financohet nga buxheti i shtetit.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr. 752, datë 30.11.2019

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.666, DATË 10.10.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE DHE PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE E TË PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19, të ligjit nr.69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr.15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të

ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr.57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 31, të vendimit nr.666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 31.1, me këtë përmbajtje:

“31.1 Përfshihet për vitin shkollor 2019-2020 përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, fëmijë të personave që kanë humbur jetën ose janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019. Institucionet arsimore vendore përkatëse, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bashkëpunim me njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, identifikojnë nxënësit dhe dërgojnë listat e nxënësve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

VENDIM

Nr.756, datë 2.12.2019

PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË FINANCIAR ZNJ. PRANVERA QATO

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor znj. Pranvera Qato, në masën e tetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr.757, datë 2.12.2019

**PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR ZNJ. LINDITA CARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor znj. Lindita Cara, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 758, datë 2.12.2019

**PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR Z. ALBERT CARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor z. Albert Cara, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 759, datë 2.12.2019

**PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR Z. ALEKS ÇUPI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor z. Aleks Çupi, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**VENDIM****Nr.760, datë 2.12.2019****PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR Z. ALBERT LALA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor z. Albert Lala, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 761, datë 2.12.2019****PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR ZNJ. DENISA GREKU**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor znj. Denisa Greku, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703 datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 762, datë 2.12.2019****PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR ZNJ. MARJANA REXHEPI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor znj. Marjana Rexhepi, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM**Nr.763, datë 2.12.2019****PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË
FINANCIAR Z. FEHMI VATA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor z. Fehmi Vata, në masën e trembëdhjetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

**VENDIM**

Nr.764, datë 2.12.2019

PËR DHËNIE TRAJTIMI TË VEÇANTË FINANCIAR ZNJ. DIANA STENEÇI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1/a, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e trajtimit të veçantë financiar mujor znj. Diana Steneçi, në masën e tetëfishit të pensionit social, të miratuar sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 nëntor 2019.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM

Nr. 2, datë 30.11.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1, DATË 29.11.2019, TË KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE, “PËR CAKTIMIN E DREJTUESVE QENDRORE TË OPERACIONIT PËR MENAXHIMIN E FATKEQËSISË NATYRORE NË QARQET DURRËS DHE TIRANË”

Në mbështetje të nenit 19, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të vendimit nr.750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë”, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile, në zbatim të masave të marra pas shpalljes së fatkeqësisë natyrore në qarkun e Durrësit, Lezhës dhe të Tiranës, i mbledhur sot më 30.11.2019,

VENDOSI:

Në vendimin nr.1, datë 29.11.2019, të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, pas emërimit “... Durrësit ...” shtohen “..., Tiranës dhe Lezhës...”.

2. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2, me këtë përmbajtje:

“2/1. Caktimin e z. Ermira Gjeçi, me detyrën e të deleguarit të KNEC-së për Qarkun Tiranë për çështjet operacionale.

“2/2. Caktimin e z. Etjen Xhafaj, me detyrën e të deleguarit të KNEC-së për Qarkun Lezhë për çështjet operacionale.

3. Në pikën 3, shprehja “... Qarkun Durrës...” zëvendësohet me fjalët “... përkatësisht për qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë...”.

4. Në pikën 4, pas referencës “2” shtohen “2/1” dhe “2/2”.

5. Kudo në vendim fjalët “... qarkun/qet e Durrësit dhe Tiranës ...” zëvendësohen me “... qarkun/qet e Durrësit, Lezhës dhe Tiranës...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT
NDËRMINISTROR
I EMERGJENCAVE CIVILE
KRYEMINISTËR
Edi Rama

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 700, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa në vendimin nr. 230, datë 13.3.2015, të Këshillit të Ministrave, ‘Për trajtimin me pagesë të qirasë së disa familjeve që preken nga zbatimi i projektit ‘Unaza e Madhe e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës’”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 147, viti 2019, fq. 12140, bëhet korrigjimi i gabimit material, konkretisht, në shtojcën 2/4, që i bashkëlidhet vendimit, mbiemri i shtetasve Klodian dhe Alfons zëvendësohet me “**Gjapi**”. Shtojca e korrigjuar si më poshtë:



Shtojca 2/4
**LISTA EMËRORE E SUBJEKTEVE QË
TRAJTOHEN ME QIRA**

Subjektet, të cilat preken nga zbatimi i projektit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Komuna e Parisit-Rruga e Kavajës, që trajtohen me pagesën e qirasë	
1	Klodian Gjapi
2	Alfons Gjapi

NDREQJE GABIMI

Në aktin normativ nr. 4, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, ‘Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë’”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 161, viti 2019, në nenin 1 të aktit, bëhet korrigjimi, si më poshtë:

fjalët “*... bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:*”, të korrigjohen me “*...bëhen shtesat e mëposhtme:*”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 140 lekë